

LIGJ
Nr. 143/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9136, DATË 11.9.2003, “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

(Ndryshuar me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 60, datë 16.9.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përçak-tuar nga Këshilli i Ministrave. Pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9, të këtij ligji, nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor.”.

Neni 2

Në nenin 7, në fund të paragrafit të parë shtohen fjalët “për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave”.

Neni 3

Në nenin 8, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 4

(Shfuqizuar me Aktin Normativ nr. 1, datë 25.1.2017)

Neni 5

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, dhe gjobat përkatëse përcaktohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 6

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2016.

Miraturar në datën 17.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9395 , datë 7.1.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani